

RREGULLORE NR. 2005/51

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-ut NR. 2004/51 MBI
TATIMIN NË TË ARDHURAT E KORPORATAVE**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në përputhje me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të datës 25 korrik 1999 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) mbi Autoritetin e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Pas shpalljes së Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/51 e datës 4 dhjetor 2004 mbi tatimin në të ardhurat e korporatave,

Duke ditur se investimet kapitale në Kosovë paraqesin një prioritet të madh për zhvillimin ekonomik dhe se projektet me shkallë të lartë të kapitalit kërkojnë dispozita adekuate tatimore për të zvogëluar rrezikun për investitorët,

Duke vepruar me kërkesë të Qeverisë dhe pas konsultimit me Këshillin ekonomik dhe fiskal,

Me qëllim të ndryshimit të nenit 14 dhe 21 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2004/51 për të siguruar një regjim real të zhvlerësimit për qëllime të tatimit në lidhje me mjetet e rënda të transportit dhe për një metodë më të thjeshtësuar për përcaktimin e zbritjeve të zhvlerësimit, si dhe për zgjatjen e periudhës së bartjes së humbjeve nga biznesi,

Shpall sa vijon:

Neni 1
Ndryshimi

1.1 Neni 14.3 ndryshohet si vijon:

14.3 E gjithë prona materiale e tatimpaguesit që i nënshtrohet zhvlerësimit sipas nënënit 14.1 caktohet në një rën prej kategorive vijuese:

(a) Kategoria 1: Ndërtesat dhe strukturat tjera ndërtimore;

(b) Kategoria 2: Veturat dhe kamionët e lehtë, mjetet e rënda për transport, pajisjet për bartje të dheut, buldozerët, gërmuesit e dheut dhe mjetet tjera të rënda, kompjuterët, pjesët shtesë për kompjuterë dhe pajisjet tjera për përpunimin e të dhënave, mobiljet dhe pajisjet për zyra, instrumentet, gjërat e ndryshme dhe pajisjet tjera shtesë;

(c) Kategoria 3: Uzinat dhe makineritë, inventari i hekurudhës dhe lokomotivat që përdoren për transport hekurudhor, aeroplanët, anijet dhe e tërë pasuria tjetër materiale.

1.2 Neni 14.5 ndryshohet si vijon:

14.5 Shuma e lejuar si zbritje për zhvlerësim në periudhën tatimore përcaktohet duke aplikuar përqindjet e mëposhtme për llogaritjen e kapitalit të një kategorie të tillë sipas metodës së drejtpërdrejtë në fund të periudhës tatimore:

(a) Kategoria 1: pesë për qind (5%);

(b) Kategoria 2: njëzet për qind (20%) dhe

(c) Kategoria 3: pesëmbëdhjetë për qind (15%).

1.3 Neni 21.2 ndryshohet si vijon:

21.2 Shuma e humbjes së biznesit e përcaktuar sipas këtij neni mund të bartet deri në shtatë (7) periudha të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 janar 2006.

Søren Jessen-Petersen
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm